

VENDIM
Nr. 650, datë 8.10.2012

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA, ME ÇMIMIN 1 (NJË) EURO, TË SIPËRFAQES 131 659 M², NGA E CILA 71 965 M² JANË NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIQEVE, ELBASAN, DHE 59 694 M² NË ADMINISTRIM TË SHOQËRISË “KOMBINATI ENERGJETIK” SHA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008 dhe në vijim të kreut V të vendimit nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për dhënien me qira, me çmimin 1 (një) euro/kontrata, të sipërfaqes prej 131 659 (njëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) m², nga e cila 71 965 (shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m² në administrim të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çelikeve, Elbasan dhe 59 694 (pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër) m² në administrim të shoqërisë “Kombinati Energjetik” sh.a. Elbasan, me qëllim zhvillimin e veprimtarive prodhuese, si më poshtë:

- a) Investimi 50 pikë;
- b) Punësimi 30 pikë;
- c) Koha e fillimit të punës 20 pikë.

2. Për dhënien me qira të zbatohen procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha